

VENDIM
Nr. 126, datë 29.8.2012

**MBI ANKIMIN ADMINISTRATIV TË “CEZ SHPËRNDARJE” SHA NË LIDHJE ME
VENDIMIN NR. 102, DATË 19.7.2012 “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS OST SHA DHE “CEZ
SHPËRNDARJE” SHA” BORDIT TË KOMISIONERËVE**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe nenit 16 pika 3 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuar me vendimin nr. 21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 29.8.2012, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi ankimin administrativ të shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për vendimin nr. 102, datë 19.7.2012,

VENDOSI:

Të mos pranojë ankimin e shoqërisë “CEZ Shpërndarje” si të pabazuar në prova të reja që mund të çojnë Bordin e Komisionerëve të ERE-s në një vendim të ndryshëm nga ai i marrë në datën 19.7.2012, dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 102, datë 19.7.2012 “Për miratimin e marrëveshjes së transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe CEZ Shpërndarje sh.a.”.

Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë “CEZ Shpërndarje” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani